

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË
NR. _____ VENDIMI

V E N D I M
I GJYQTARIT TË VETËM

Në Tiranë sot më datë 23-07-2007 unë Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Elona Reme, mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga Shoqëria "YLDON" Sh.p.k, perfaqesuar nga Administratori Ligjor i saj **Z. Ylli Ndroqi** i cili kërkon depozitimin e Vendimit Nr.2, date 20/06/2007 të Ortakut të vetem të Shoqërisë për miratimin e Raportit të Ekspertit Kontabel të Autorizuar për rritjen e kapitalit themeltar të shoqërisë. Pasi shqyrtova kërkesën e tij dhe u njoha me aktet perketase,

K O N S T A T O V A

Se me vendimin Nr. 29119 datë 19.02.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është rregjistruar si person juridik shoqëria "YLDON" Sh.p.k

Me vendimin Nr.2 datë 20/06/2007 të Asamblesë së ortakut të vetem të shoqërisë "YLDON" Sh.p.k është vendosur:

- Miratimi i raportit të ekspertit kontabel të autorizuar për zmadhimin e kapitalit themeltar të Shoqërisë "YLDON" Sh.p.k
- Kapitali i nënshkruar i shoqërisë "YLDON" Sh.p.k nga 51.768.592 Leke behet 53.900.000 Leke si rikapitalizim i fitimit të vitit ushtrimor 2006, nga ana e shoqërisë.
- Të pasqyrohen ndryshimet perketase në Aktin e Themelimit dhe në Statutin e Shoqërisë "YLDON" Sh.p.k.
- Depozitimi i këtyre akteve pranë Zyrës së Rregjistrimit Tregtar, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Pasi shqyrtova kërkesën e tij, çmova se ajo është e drejte dhe e bazuar në ligj.

PER KETO ARSYE


Në mbështetje të Ligjit 7667 datë 28.01.1993 “ Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që duhen respektuar për shoqëritë Tregtare” dhe Ligjit Nr. 7638 datë 19.11.1992 “ Për shoqëritë Tregtare”

VENDOSA

- Pranimin e Kerkeses.
- Depozitimin e vendimit Nr.2 datë 20/06/2007 të shoqërisë “YLDON” Sh.p.k
- Miratimi i raportit të ekspertit kontabël të autorizuar për zmadhimin e kapitalit themeltar nëpërmjet rikapitalizimit te fitimit te vitit ushtrimor 2006.
- Kapitali i nënshkruar i shoqërisë “ YLDON” Sh.p.k nga 51.768.592 Leke behet 53.900.000 Leke .
- Depozitimi i këtyre akteve pranë Zyrës së Rregjistrimit Tregtar, prane Gjyqates se Rrethit Gjyqesor Tirane.
- Urdhërohet Zyra e Rregjistrimit Tregtar të bëj ndryshimet në kollonat përkatëse duke i ndarë rregjistrimet nga njëri - tjetri me vijë të kuqe.
- Ndaj ketij Vendimi lejohet ankim sipas ligjit.

Tirane me 03/07/2007

GJYQTARE

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Ilirije Huri", written over a horizontal line.